



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

3 Prill 2018

NJOFTIM PËR BOTIM TË ARTIKUJVE NË REVISTËN PEDAGOGJIKE

**Të nderuar bashkëpunëtorë dhe të interesuar për të botuar në Revistën Pedagogjike,
IZHA, 2018**

Ju njoftojmë se janë hapur aplikimet për të dërguar artikuj për numrin e ri të Revistës Pedagogjike 2018.

Revista pedagogjike është botim i Institutit të Zhvillimit të Arsimit me ISSN 0304-3509.

Fokusi i revistës në këtë numër është “Mirëqënia e fëmijëve dhe të rinjve - procese, nisma, mundësi dhe sfida për promovimin e saj në fushën e edukimit”. Përmes këtij fokusi synojmë të mundësojmë ndarjen e ideve, parashtrimin e analizave, përvojave dhe kërkimeve.

Për të orientuar trajtesat tuaja përkundrejt fokusit të revistës dhe çështjeve që lidhen me të, pak fjalë mbi mirëqënien në fushën e edukimit. Mirëqënia e fëmijëve dhe të rinjve është në vëmendje të politikave arsimore më së pari për rëndësinë që ajo ka për shëndetin, sigurinë dhe vetëfunksionimin e tyre si individë dhe anëtarë të shoqërisë, sikurse dhe për faktin se çon drejt rezultateve më të mira arsimore. Ajo sigurohet kur fëmijët dhe të rinjtë përmbushin potencialin e tyre, aftësohen të menaxhojnë situatat e jetës së përditshme dhe të zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë dhe pjesëmarrjes në komunitet.

Mirëqënia si koncept në edukim është shumëdimensionale dhe përfshin mirëqënien konjitive, fizike, sociale dhe emocionale të fëmijëve dhe të rinjve. Roli i institucioneve arsimore, stafeve të shkollave, prindërve dhe partnerëve të tjerë në fushën e edukimit është tepër i rëndësishëm në këtë drejtim lidhur me përgjegjësitë dhe veprimet që duhet të ndërmerren për të siguruar që fëmijët, të rinjtë të qasen pozitivisht ndaj procesit të të nxënies, të ndërtojnë marrëdhënie bazuar në respektin e ndërsjellë, të ndjehen të vlerësuar, të mbështetur dhe të nxitur për të qenë të suksesshëm.

Duke marrë në konsideratë tërësinë e faktorëve që ndikojnë mirëqënien e fëmijëve dhe të rinjve, objekt i kësaj reviste do të jenë specifiku ato faktorë që lidhen me fushën e edukimit, rolin e institucioneve arsimore dhe aktorëve të angazhuar, mundësitë dhe sfidat në këtë proces.

Artikujt mund të sjellin analiza, parashtrime, reflektime, kërkime dhe oponenta mbi çështjet e mëposhtme:

- Mirëqënia e fëmijëve dhe të rinjve në qendër të politikave arsimore për mbështetjen dhe promovimin e saj;
- Adresimi i mirëqënies së nxënësve përmes kurrikulës me bazë kompetencat – Zhvillimi i kompetencës personale;
- Mësimdhënia dhe të nxënit në funksion të përmbushjes së potencialit të fëmijëve dhe të rinjve;
- Gjithëpërfshirja dhe klima e shkollës si faktorë që potencojnë dhe mbështesin mirëqënien e fëmijëve dhe të rinjve;
- Vlerësimi i nxënësve si instrument që nxit konceptin pozitiv për veten;
- Roli dhe rëndësia e partneritetit me prindërit dhe komunitetin për mbështetjen e nxënësve në dobi të suksesit të tyre;
- Shëndeti dhe mirëqënia e nxënësve;
- Strukturat mbështetëse në shkollë në funksion të sigurimit të mirëqënies së nxënësve (psikologu shkollor, punonjësi social, oficerët e sigurisë etj);
- Mirëqënia e nxënësve dhe siguria në shkollë;
- Nevoja për zhvillim të vazhduar profesional të mësuesve në funksion të mbështetjes së zhvillimit akademik të nxënësve, përmbushjes së nevojave dhe interesave të tyre.

PROCESI I PËRZGJEDHJES DHE PRANIMIT PËR BOTIM NË REVISTËN PEDAGOGJIKE

Faza e parë – Dorëzimi i abstraktit

Në fazën e parë të aplikimit të interesuarit për botim dorëzojnë një abstrakt të çështjeve kryesore që artikulli merr përsipër të trajtojë. Çdo autor ka të drejtë të sjellë vetëm një artikull për botim.

Formati i abstraktit

Titulli i artikullit:

Emri mbiemri i autorit/autorëve, Titulli/Grada (nëse ka), Institucioni ku punon:

Abstrakt i artikullit ku përshkruhet fokusi i tij, jo më shumë se 200-250 fjalë

Fjalë kyçe: 5 – 10 fjalë

Afati përfundimtar për fazën e parë të aplikimit është 27 Prill 2018.

Faza e dytë – Miratimi i abstrakteve dhe përgatitja e artikujve

Në fazën e dytë, pas reflektimit mbi abstraktet të Bordit editorial të revistës, ju do të njoftoheni përmes email-it për pranimin e abstraktit dhe vazhdimin më tej të përgatitjes së artikullit e dorëzimit në afatin e përcaktuar.

Formati i artikullit të plotë

Titulli i artikullit:

Emri i autorit/autorëve:

Abstrakt:

Fjalët kyçe:

Hyrje:

Shtjellimi i çështjeve kryesore të artikullit:

Rezultate mbi çështjet kryesore:

Konkluzione/diskutime:

Rekomandime:

Bibliografia:

Kritere për përgatitjen e artikujve të revistës Pedagogjike

- Numri i faqeve të artikullit: jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 12 faqe.

- Formati është A4, shkrim 12, Times New Roman, me një hapësirë single midis rreshtave.
- Artikulli duhet të jetë i shoqëruar me një abstrakt 200-250 fjalë.
- Referencat përgjatë artikullit duhet të vendosen me numra dhe në fund të faqes të vendoset referenca e plotë me shkrim 10, Times New Roman.
- Në fund të artikullit duhet të vendoset bibliografia që përfshin autorin, titullin e botimit, shtëpinë botuese, vendi, viti i botimit, numri i faqeve.

Abstraktet dhe artikujt do të dorëzohen në formë elektronike në adresat: mastorievis@yahoo.com , violakarapici@hotmail.com